VENDIM
Nr. 35, datë 4.3.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "DEVOLL HIDROPOWER" SHA NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

(ndryshuar me vendimin nr. 159, datë 29.10.2019)

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa "a"; 9 dhe 13, pika 1, germa "d", të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa "g"; 5, pika 2; 8 dhe 13 dhe 14, pika 1, të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 4.3.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Devoll Hidropower" sh.a., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Devoll Hidropower" sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/10, germat "a", "b" dhe "c") është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Devoll Hidropower" sh.a., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar.[1]

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti

[1] Me vendimin nr. 159, datë 29.10.2019, Bordi i Komisionerëvet ë ERE-s vendosi:
1. Rinovimin e licencës së shoqërisë "Devoll Hydropwer" sh.a., me nr. 274, seria T15 të miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s, nr. 35, datë 4.3.2015, në veprimtarinë e Tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar, duke filluar që nga data 5.3.2020.